



KRYETARI I KOMUNËS

Nr.390 datë: 29.12.2021

K a m e n i c ë

Bazuar në nenin 13 dhe 58 Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 78 të Statutit Sh.01.nr.005/2008 të datës 26.09.2008 dhe Vendimit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Statutit Sh.01.Nr.15/2010 të datës 31.05.2010 të Komunës së Kamënicës, nenit 53 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe Propozimit nga Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) për anulim të pjesërishtëm të Vendimit Nr.19870 të datës 10.09.2020. Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

1. MIRATOHET propozim vendimi Sh.02.Nr.19870 i datës 10.09.2021 i Drejtorisë Komunale të Arsimit Kamënicë, lidhur me shfuqizimin e pjesërishtëm të vendimit Sh.02.Nr.19870 i datës 10.09.2020 për riorganizimin e arsimit.
2. SHFUQIZOHEN pikat nga vendimi Sh.02.Nr.19870 i datës 10.09.2020 si në vijim:

2.1 Pika 1 paragrafi 1.1 (*niveli 0,1 dhe 2 të ISCED-it niveli parashkollor, arsimi fillor 1-5 dhe arsimi i mesëm i ulët 6-9*) të Vendimit Sh.02.Nr. 19870 i datës 10.09.2020 për vijim të mësimin në institucionin arsimor "Avni Rrustemi" në Karaqevë të Epërme, dhe rikthehen për vijimin e mësimin në SHFMU "Asllan Thaçi" Karaqevë e Poshtme.

2.2 Pika 2 paragrafi 2.1 (*niveli 0,1 dhe 2 të ISCED-it niveli parashkollor, arsimi fillor 1-5 dhe arsimi i mesëm i ulët 6-9*) të Vendimit Sh.02.Nr. 19870 i datës 10.09.2020 për vijim të mësimin në institucionin arsimor "Rexhep Mala" në Topanicë dhe rikthehen për vijimin e mësimin në SHFMU "Xhelal Sopi" në Petrovc.

2.3 Pika 3 paragrafi 3.1 (*niveli 0,1 dhe 2 të ISCED-it niveli parashkollor, arsimi fillor 1-5 dhe arsimi i mesëm i ulët 6-9*) të Vendimit Sh.02.Nr. 19870 i datës 10.09.2020 për vijim të mësimin, shfuqizohet vetëm pjesërishtë për paralelën e ndarë në Kopërnice për vijimin e mësimin në institucionin arsimor "Skënderbeu" në Hogosht dhe rikthehen në

vijimin e mësimit në institucionin arsimor në fshatin Kopernicë, paralelja e ndarë në Hogosht.

2.4 Pika 4 paragrafi 4.1 (niveli 0,1 dhe 2 të ISCED-it niveli parashkollor, arsimit fillor 1-5 dhe arsimit mesëm i ulët 6-9) të Vendimit Sh.02.Nr. 19870 i datës 10.09.2020 për vijim të mësimit, shfuqizohet vetëm pjesërisht për paralelen e ndarë në Shipashnicë të Poshtme për vijimin e mësimit në institucionin arsimor "Sadri Misini" Shipashnicë e Epërme dhe rikthehen në vijimin e mësimit në institucionin arsimor të fshatin Shipashnicë e Poshtme paralelja e ndarë në Shipashnicë e Epërme, të Vendimit Sh.02.Nr. 19870 i datës 10.09.2020 për vijim të mësimit.

3. Mbetet në fuqi pjesa tjetër e Vendimit Sh.02.Nr.19870 i datës 10.09.2020 për vijimin e mësimit.
4. Obligohet Drejtoria Komunale e Arsimit që të njoftoj stafin mësimor dhe nxënësit për fillimin e vijimit të mësimit.
5. Zbatimin e vendimit e bënë Drejtoria e Arsimit, ndërsa mbikëqyrjen për zbatimin e tij e bënë Kryetari i Komunës.
6. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është propozim vendimi Sh.02.Nr.37734 i datës 15.12.2021 i Drejtorisë Komunale të Arsimit në Kamenicë dhe vendimit Bazë Sh.02.Nr.19870 i datës 10.09.2020
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës

A r s y e t i m

Komuna e Kamenicës me Vendimin Sh.02.Nr. 19870 i datës 10.09.2020 ka marr vendim për riorganizimin e mësimit dhe vijimit të rregullt të mësimit në disa fshatra, sipas të cilit vendim nxënësit e SHFMU "Asllan Thaçi" nga Karaqeva e Poshtme, vijojnë mësimin në institucionin arsimor "Avni Rrustemi" në Karaqevë të Epërme, nxënësit e SHFMU "Xhelal Sopi" nga Petrovci të vijojnë mësimin në institucionin arsimor në "Rexhep Mala", nxënësit nga paralelja e ndarë në fshatin Kopernicë vijojnë mësimin në institucionin arsimor "Skënderbeu" në Hogosht, nxënësit nga paralelja e ndarë në fshatin Shipashnicë e Poshtme, të vijojn mësimin në institucionin arsimor në "Sadri Misini" në Shipashnicë të Epërme.

Me datë 15.12.2021 Kryetari i Komunës ka pranuar propozim vendim për shfuqizimin e pjesërishtë të vendimit me Sh.02.Nr.19870 i datës 10.09.2021 për riorganizimin e mësimit,

sipas të cilit në disa shkolla në të cilat është riorganizuar mësimi, nuk është duke u zhvilluar procesi mësimor dhe vijimi i rregullt, dhe vendimi si i tillë vetëm pjesërisht është i zbatueshëm.

Nga fakti se vendimi i tillë nuk ishte marrë në pajtim me nenin 20 paragrafi 20.1 të Statutit të Komunës së Kamenicës, që thotë se Komuna duhet të konsultoj publikun në mënyrë që të siguroj se vendimi i marrë është bazuar në fakte apo që të jenë marrë parasysh sugjerimet dhe përvojat e qytetarëve në mënyrë që të zbatohen në mënyrë efektive në praktikë, kjo bëri që të pasojë humbja e mësimimit në vazhdimësi nga qindra nxënës, nga marrja e këtij vendimi e deri më sot.

Pra, bazuar në Propozimin e Drejtorisë Komunale të Arsimit në Kamenicë, se në shkollat e lartëcekura nuk është duke u zhvilluar mësimi, Kryetari i Komunës në mbështetje të nenit 53 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi që ky vendim të shfuqizohet pjesërisht për institucionet arsimore në të cilat nuk është duke u zhvilluar procesi mësimor dhe vijimi i rregullt i mësimimit.

Nga të cekurat si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit
- DKA-së
- MASHT-it
- QSHQ-arkiv

Kryetari i Komunës

Kadri RAHIMAJ